



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj. Them. 7118/2569/501

Nr. Vendimit 549

Data e rregjistrimit 16.09.2014

Data e vendimit 17.03.2016

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Lindita SINANAJ	KRYESUESE
Artur MALAJ	ANËTAR
Alkelina GAZIDEDJA	ANËTARE

me *sekretare gjyqësore Visela Kashari*, në Tiranë, sot më datë 17.03.2016, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

PADITËSE: *Qendra "Res-Publika",* adresa: Rruga.Th.Ziko,
P.65'1, Sh.3, Ap.9, Tiranë.

E PADITUR: *Ministria e Mbrojtjes.*

OBJEKTI: Detyrimin e të paditurit të japë informacionin dhe dokumentat zyrtare të kërkuara nga paditësi, në lidhje me:

a) Shumën e shpenzuar nga institucioni për reklamat audiovizive; shpallje në shtypin e shkruar

dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

b) Listën e shoqërive tregtare që janë kontraktuar/paguar për spotet audiovizive përfshirë produksionin dhe transmetimin ose publikimin, si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekt tregtar.

BAZA LIGJORE: Neni 23 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë; neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 9/1, 10, 13/1, 14, 18/b, 20, 45/1, 51, 55, 118 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative; nenet 3, 7 të ligjit nr. 8503 datë 30.06.1999 *“Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”*; nenet 31, 32/a të Kodit të Procedurës Civile; nenet 15/a, 17/1/c/f të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoji relatimin e çështjes nga kryesuesja e seancës dhe bisedoi çështjen në tërësi:

VËREN

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.09.2014 është rregjistruar ankimi i paraqitur nga pala paditëse, Qendra “Res-Republika” kundër vendimit nr. 1685 datë 16.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenet 442, 443 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 48 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*. Ky ankim është

paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 29.04.2014. Kjo gjykatë me vendimin e datës 29.04.2014 ka vendosur pranimin e ankimit të palës paditëse, duke e dërguar atë në Gjykatën Administrative të Apelit, së bashku me aktet e njoftimit të tij, si dhe dosjen e gjykimit për shqyrtim.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 19.02.2014, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padinë objekt gjykimi. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 1685, datë 16.04.2014, ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e në prova. Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës paditëse. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për palët prezente”*.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse, Qendra “Res-Publika” duke parashtruar këto pretendime:

- ✓ Vendimi i gjykatës nuk është i mbështetur në ligj dhe në prova.
- ✓ Gjykata ka bërë një interpretim të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 8503, datë 30.06.1999 *“Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”*.
- ✓ Nga ana e palës së paditur, Ministria e Mbrojtjes, nuk është ngritur asnjë herë pretendimi se informacioni i kërkuar nuk mund t’i jepet palës paditëse për shkak se përbën sekret shtetëror.
- ✓ Informacioni i kërkuar nuk përfshihet në dokumentat që përbëjnë sekret hetimor, pasi informacioni dhe dokumentat që ka kërkuar pala paditëse, kanë qenë publike dhe nuk janë formuar gjatë hetimeve paraprake.
- ✓ Pala paditëse, Qendra “Res-Publika” kërkon të informohet në lidhje me shumën e shpenzimeve dhe jo me dokumenta të posacëm, informacion ky që disponohet nga disa organe si Arkiva e Ministrisë së Mbrojtjes, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Auditit në Ministrinë e Mbrojtjes, etj.
- ✓ Gjykata ka gabuar në shtrirjen e klasifikimit të dokumentave si sekret hetimor për të gjithë objektin e padisë.
- ✓ Për informacionet dhe dokumentat e kërkuara për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të mos iu vënë në dispozicion paditësit, sepse për këto

dokumenta nuk është provuar të jenë pjesë e ndonjë hetimi.

Për sa më sipër pala paditëse, Qendra "Res-Publika", ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 1685, datë 16.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë sipas objektit.

Faktet e parashtruara para gjykatës:

Qendra "Res Publika" është person juridik i regjistruar me vendimin nr. 604, datë 13.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si organizatë jofitimprurëse, objekti i të cilës është mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të kategorive të pambrojtura, si dhe e interesat e tjerë të ligjshëm të tyre në fushat e veprimtarisë së saj, ofrimi i shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo të mbrojtjes juridike në proceset gjyqësore penale, civile dhe administrative etj. Konstatohet se me shkresën e datës 16.10.2013 pala paditëse i është drejtuar palës së paditur, Ministria e Mbrojtjes, duke kërkuar informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentave zyrtare në lidhje shumën e shpenzuar nga institucioni për reklamat audiovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, si dhe listën e shoqërive tregtare që janë kontraktuar, paguar për spotet audiovizive përfshirë produksionin dhe transmetimin, ose publikimin, si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekt tregtar, informacion ky i cili nuk i është vënë në dispozicion nga pala e paditur.

Konstatohet se me kërkesën nr. 037/13 prot., datë 27.11.2013, paditësi ka paraqitur ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopjeve të dokumentave zyrtare, po pavarësisht këtij ankimi nga ana e palës së paditur nuk është kthyer përgjigje lidhur me kërkesën në fjalë. Në këto kushte, Qendra "Res Publica" i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë padinë objekt gjykimi, e cila vlerësuar e pabazuar në ligj dhe në prova.

Fillimisht, gjykata e shkallës së parë ka argumentuar se e drejta e informimit është një e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por në nenin 17 të saj është përcaktuar edhe kufizimi i kësaj të drejte që mund të vendoset vetëm me ligj, e po ashtu kufizime të kësaj natyre janë parashikuar edhe në pikën 2 të nenit 10 të Konventës

Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në rastin konkret, neni 103 i Kodit të Procedurës Penale ndalon publikimin qoftë edhe pjesërisht të akteve sekrete që lidhen me çështjen, si edhe të akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprahe.

Në analizë të akteve shkresore të administruara në gjykim, konstatohet se pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, ka bërë kallëzim penal dhe në vijim është regjistruar procedimi penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në lidhje me procedurën e prokurorit publik realizuar nga ky institucion më datë 26.04.2013, në lidhje me prodhimin e tre spoteve televizive, dokumentarëve si dhe transmetimin e tyre në dy media kombëtare. Referuar përmbajtjes së shkresës nr. 684 prot., datë 17.01.2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, konstatohet se ndalohet të publikohen qoftë edhe pjesërisht aktet e hetimeve paprahe deri në përfundim të procesit dhe në përputhje me nenin 295/a të Kodit Penal, zbulimi në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, ose duke abuzuar me cilësitë ndaj të tretëve, i të dhënave ose ndihma për të zbuluar të dhënat, të cilat ligji i përcakton si sekret, në rastin konkret sekret hetimor, përbën vepër penale. Pra rezulton se objekti i informacionit të kërkuar nga pala paditëse jo vetëm që është bërë objekt hetimi penal, por pala e paditur e ka të ndaluar publikimin e tyre deri në përfundim të hetimit.

Për sa më sipër, bazuar në paragrafin 4 të nenit 295/a të Kodit Penal, gjykata cmon se pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, ka patur detyrimin ligjor për mospublikimin e këtyre informacioneve që përbëjnë sekret hetimor dhe me të drejtë nuk ka pranuar kërkesën e palës paditëse. Gjykata ka arsyetuar se mosvënia në dispozicion të palës paditëse e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar prej saj është në përputhje me ligjin dhe konkretisht me nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale.

Vlerësimi nga Gjykata Administrative e Apelit

Së pari gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma “a”, nenit 10, paragrafi 2 gërma “a” dhe nenit 44 të ligjit nr. 49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Së dyti vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 16.04.2014, ndërsa ankimi nga pala paditëse Qendra "Res-Publika" është paraqitur në datën 29.04.2014, pra brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementet e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankim, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata cmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit nr. 1685, datë 16.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

Së treti Në analizë të pretendimeve të parashtruara nga pala paditëse, të rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë, është marrë në vlerësim e zbatim të gabuar të ligjit. Për të arsyetuar mbi bazueshmërinë e pretendimeve të paraqitura në kërkesë padi dhe ankim nga pala paditëse, kjo Gjykatë cmon të marrë në analizë parashikimet e bëra në ligjin e posacëm që rregullon mosmarrëveshjen objekt gjykimi, ligjin nr. 8503 datë 30.06.1999 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare*", i cili është ligji që rregullon të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, si dhe aspektet e lidhura me ushtrimin e kësaj të drejte.

Lidhur me të drejtën e informimit, në nenin 3 të këtij ligji është përcaktuar se: "*Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qënë i detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përvec rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe. Çdo informacion për një dokument zyrtar, që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur ky informacion përbën të dhëna vetjake të vetë personit, të cilit i është dhënë informacioni*".

Në interpretim të kësaj dispozite, konstatohet se cdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, përmbajtja e të cilave reflekton veprimtarinë e organeve shtetërore dhe kërkesa e paraqitur nga ky subjekt aktivizon detyrimin e organit të administratës publike, për të dhënë informacionin e kërkuar, përveç rasteve kur vetë ligji parashikon ndryshe. Në këtë kontekst, vlerësohet se pala paditëse, Qendra "Res-Publika" ka interes të ligjshëm dhe përbën subjekt të legjitimuar për t'ju drejtuar organeve shtetërore dhe për të marrë prej tyre informacionin e kërkuar, për sa kohë që ligji i posacëm nuk ka vendosur kriteret lidhur me subjektet që gëzojnë të drejtën për të paraqitur kërkesa të kësaj natyre dhe natyrën e dokumentit zyrtar të kërkuar, përveç atyre rasteve kur kufizimi i kësaj të drejte është vendosur shprehimisht në ligj.

Në analizë të akteve e provave shkresore të administruara në gjykim, rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e kallëzimit penal të depozituar nga Ministria e Mbrojtjes, është regjistruar procedimi penal nr. 7387 i vitit 2013, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal. Objekti i kallëzimit penal ka të bëjë me realizimin në vitin 2013 të procedurës së prokurimit me objekt *"Prodhimin e tre spoteve televizive dhe tre dokumentarëve, si dhe transmetimin e tyre në dy media kombëtare"*, me fond limit 99.943.488 lekë, zhvilluar në datën 26.04.2013 nga pala e paditur në cilësinë e autoritetit kontraktor. Bazuar në konsideratat e mësipërme, për sa kohë që informacionet e kërkuara nga paditësi janë objekt i procedimit penal të organeve kompetente të prokurorisë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë është shprehur mbi ndalimin e dhënies së informacionit të kërkuar palës paditëse, Qendra "Res-Publika".

Në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me ndalimin e publikimit të aktit, është parashikuar se: *"1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake"*.

Në interpretim të kësaj dispozite, rezulton se publikimi qoftë i plotë ose i pjesshëm i akteve sekrete ose jo që lidhen me çështjen, është i ndaluar deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

Në rastin konkret, konstatohet se i gjithë informacioni i kërkuar nga pala paditëse për vitin 2013, është objekt i procedimit penal i cili ende nuk ka përfunduar, për sa kohë që nuk ka një vendim të prokurorit për pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë, në zbatim të nenit 327, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale. Për sa më sipër, në çështjen objekt gjykimi jemi në rastin përjashtimor të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr. 8503, datë 30.06.1999 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”*, ku përcaktohet se autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe. Në këto kushte, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se informacioni i kërkuar nga pala paditëse nuk mund t'i vihet në dispozicion, për sa kohë që ekziston ndalimi i shprehur në ligjin e posacëm dhe në Kodin e Procedurës Penale. Në rast se pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, do të procedonte me dhënien e informacionit dhe të dokumenteve zyrtare të kërkuara nga pala paditëse, do të konsumonte veprën penale të zbulimit të akteve ose të dhënave sekrete, të parashikuar në nenin 295/a të Kodit Penal, në të cilin parashikohet se: *“Zbulimi ndaj të tretëve i të dhënave ose ndihma për të zbuluar të dhënat, të cilat ligji i përcakton si sekret, nga ana e një funksionari publik ose e një personi të ngarkuar me një shërbim publik, në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose duke abuzuar me cilësitë e veta, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet...Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave të përmbajtura në aktet sekrete nga persona të tjerë, që kanë dijeni për të dhëna për procedimin penal e që janë paralajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore për moszbulimin e tyre, dënohet me burgim deri në tre vjet”*.

Pavarësisht sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se disponimi i gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin tërësisht të kërkesë padisë është i gabuar, për shkak se ndalimi i vendosur me ligj, i evidentuar si më sipër në këtë vendim, nuk i shtrin efektet e tij për të gjithë kërkimet e parashtruara nga pala paditëse, Qendra “Res-Publika”. Konkretnisht në kërkesë padinë e paraqitur në gjykatën e shkallës së parë, pala paditëse ka kërkuar detyrimin e palës së paditur që të japë informacionin dhe dokumentat zyrtare në lidhje me shumën e shpenzuar nga institucioni për reklamat audiovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 dhe listën e shoqërive tregtare që janë kontraktuar/paguar për spotet audiovizive përfshirë produksionin dhe transmetimin ose publikimin, si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekt tregtar. Pra, konstatohet se pala

paditëse ka kërkuar informacion dhe dokumentet zyrtare për veprimtarinë e palës së paditur, Ministria e Mbrojtjes, gjatë viteve 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 dhe jo vetëm për vitin 2013. Në vijim të analizës së mësipërme, konkludohet se ndalimi i palës së paditur për t'i dhënë palës paditëse informacionin e kërkuar konsiston vetëm në ndalimin e dhënies së atij informacioni dhe dokumenteve zyrtare që i përkasin vitit 2013, pjesë e procedimit penal të nisur pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Për rrjedhojë, për sa kohë që për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, nuk rezultoi e provuar në gjykim, madje as nuk u pretendua nga pala e paditur, ekzistenca e pengesave të ligjshme, konstatimi i të cilave jo vetëm që i jep të drejtë, por edhe ngarkon palën e paditur me detyrimin për mosbërjen publike të të dhënave të kërkuara, kjo e fundit, ka detyrimin për të vënë në dispozicion të palës paditëse të gjithë informacionin e kërkuar, në kuadër të realizimit të së drejtës së saj të ligjshme për informimin për dokumentet zyrtare. Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, ka detyrimin t'i japë palës paditëse informacion dhe dokumentat zyrtare të kërkuara në lidhje me shumën e shpenzuar nga ky institucion për reklamat audovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, si dhe listën e shoqërive tregëtare që janë kontaktuar/paguar për spotet audovizive përfshi produksionin dhe transmetimin ose publikimin si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekt tregëtar.

Përvec sa më sipër, kjo Gjykatë cmon të theksojë faktin se, në bazë të parashikimeve të bëra në ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 *"Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"*, pala e paditur kishte detyrimin t'i përgjigjej kërkesës së palës paditëse, pavarësisht se informacioni dhe dokumentat zyrtare të kërkuara nga ana e saj, nuk mund t'i vireshin në dispozicion kësaj të fundit, për shkak të pengesave ligjore. Konkretisht në nenin 4 të këtij ligji është parashikuar se: *"Nëse informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i lëshon kërkuarit një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund ta kërkojë atë. Nëse kufizimi është vetëm për një pjesë të të dhënave të dokumentit zyrtar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit"*. Ndërsa në nenin 10 të ligjit në fjalë është përcaktuar se: *"Autoriteti publik vendos për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj. Në rastin e mospranimit të kërkesës, përgjigjja negative, e plotë ose e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik"*.

Në interpretim të këtyre dispozitave, kjo Gjykatë arsyeton se pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, kishte detyrimin që t'i përgjigjej zyrtarisht kërkesës së palës paditëse, si në rastin kur eventualisht mund të vendoste për refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar, ku duhej që kërkesën ta shoqëronte me një deklaratë me shkrim, në të cilën të tregoheshin arsyet e mosdhënies së informacionit, si në rastin e mospranimit të plotë ose të pjesshëm të kërkesës, përgjigje kjo e cila duhet t'i kthehej palës paditëse brenda 15 ditëve nga depozitimi i kërkesës. Në analizë të akteve e provave shpresore të administruara në gjykim, nuk rezulton që pala e paditur të ketë mbajtur një qëndrim zyrtar lidhur me mundësinë e vënies në dispozicion të informacionit dhe dokumenteve zyrtarë të kërkuara nga pala paditëse, rrethanë kjo që përbën kundërbajtje administrative, në kuptim të nenit 14 të ligjit nr. 8503, datë 30.06.1999 *"Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"*, në të cilin është parashikuar se: *"Shkelja e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përben vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe rregullohet në bazë të ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative" me plotësimet e mëvonshme"*.

Për rrjedhojë të sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson se padia në gjykim duhet pranuar pjesërisht sipas argumentimit të mësipërm, ndaj vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, referuar nenit 50 gërma "c" të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, gërma "c" të ligjit nr. 49/2012 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"*.

VENDOSI

-Ndryshimin e vendimit nr. 1685 datë 16.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

-Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit Qendra Res-Publika.

-Detyrimin e palës së paditur Ministria e Mbrojtjes, t'i japë palës paditëse informacion dhe dokumentat zyrtare të kërkuara nga paditësi në lidhje me shumën e shpenzuar nga ky institucion për reklamat audovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, si dhe listën e shoqërive tregëtare që janë kontaktuar/paguar për spotet audovizive përfshi produksionin dhe transmetimin ose publikimin si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekt tregëtar.

-Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.

-Shpenzimet gjyqësore palës së paditur.

-Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Tiranë më 17.03.2016.

ANËTARE
Alkelina GAZIDEDJA
dv

ANËTAR
Artur MALAJ
dv

KRYESUESE
Lindita SINANAJ
dv

Vertetohet njësia me origjinalin

Kancelari
Leonard Stankaj
Stankaj